



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr 3618/4 prot

Tiranë, më 13 /05 / 2014

Lënda: Procedurat e vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese si dhe formati i vërtetimit.

PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË APLIKIMIT PËR NJOHJE NGA KMR SI EKSPTERT I KUALIFIKUAR PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JONIZUESE SI DHE FORMATI I VËRTETIMIT

Mbështetur në Ligjin 8025 datë 9/11/1995, i ndryshuar dhe rregulloret për liçensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese, nr 10, datë 7.1.2010 neni 3. "... ekspertiza në lidhje me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin realizohet nga përdoruesit, persona fizikë e juridikë me mbështetjen e ekspertëve në këto fusha (të njohur nga ana e KMR-së), rregulloren për punë të sigurt me burimet e rrezatimeve jonizuese nr. 543, datë 7.7.2010 neni 18 pika 1, "zbatimi i standardeve dhe sigurimi i këshillave bëhet nga ekspertë të kualifikuar që duhet të përcaktohen për qëllimet e mësipërme, dhe pika 2. Komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi duhet të përcaktojë kriteret të qarta për ekspertët e kualifikuar", KMR përcakton procedurat dhe kriteret për njohjen nga ana e KMR-së

Aplikimi për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar bëhet për të gjitha veprimtaritë që i parashikon ligji "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese " Nr. 8025 datë 9/11/1995 ,i ndryshuar. Aplikimi për njohje bëhet pranë IFBZ (Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar) tek personi i ngarkuar për këtë qëllim (jo në mënyrë elektronike ose me postë). Personi përgjegjës pret aplikuesin dhe i sqaron kriteret për vlerësim. Pas plotësimit të dokumentacionit, ai dorëzohet në QFBZ duke shënuar datën e dorëzimit, nr e fletëve, sipas formatit të përcaktuar (bashkëngjitur këtij materiali) dhe mbahet në dy kopje. Një kopje i jepet aplikuesit si vërtetim i dorëzimit të dokumentacionit. Personi përgjegjës i IFBZ-së bën një vlerësim të përgjithshëm të aplikimit duke parë plotësimin e të gjithë rubrikave dhe pas plotësimit të dosjes, ajo siglohet në faqen e parë nga ai dhe i paraqitet Drejtorit të IFBZ. Drejtori pasi e siglon ja kalon grupit të punës për vlerësimin e aplikimit për njohje eksperti. Në varësi të dokumentave të dorëzuara mblidhet grupi i vlerësimit, i cili bën një vlerësim me shkrim në lidhje me dokumentat e paraqitura jo më vonë se tre muaj nga momenti i aplikimit. Vlerësimi realizohet kundrejt kriterëve të miratuara nga ana e KMR-së. Grupi i vlerësimit përbëhet nga përfaqësues dhe ekspertë. Me përgatitjen e vlerësimit, ai dërgohet me shkrim tek sekretari i KMR-së së bashku me dosjen përkatëse. Sekretari i KMR-së përgatit propozimin për njohje nga ana e KMR-së në mbledhjen e radhës për vlerësimin përfundimtar. KMR mban inventarin e dosjeve dhe vlersimeve.

Në mbledhjen datë 28 Mars 2014 , KMR vendosi rishikimin e kriterëve dhe do të njohë si ekspertë ato persona të cilët deri më datë.31 Dhjetor 2010 plotësojnë kushtet e mëposhtme

Kritere Vlerësimi :

- 1-Disponojnë diplomë në degën e fizikës pesëvjeçare, master në fizikë, diplomë në inxhinieri (pesëvjeçare, Kimi ose Biologji) ose master në inxhinieri (Kimi ose Biologji)
 - 2-Eksperiencë pune prej 7 vitesh në këtë fushë(mbrojtje nga rrezatimet)
 - 3-Kualifikime të ndryshme në fushën e rrezatimeve jonizuese, të cilat të përfshijnë: Bazat e fizikës bërthamore dhe bashkëveprimi i rrezatimit me lëndën .
- Efektin biologjik të rrezatimeve jonizuese

Bazat në Radiometri
Dozimetri,
Përcaktimet të trashësisë së veshjeve
Legjislacionin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, si dhe njohuri mbi standartet bazë të sigurisë

Pas datës 31 Dhjetor 2010 KMR do të njohë si ekspertë personat të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

Kritere Vlerësimi :

- 1-Disponojnë diplomë në degën e fizikës pesëvjeçare, master në fizikë, diplomë në inxhinieri (pesëvjeçare, Kimi ose Biologji) ose master në inxhinieri (Kimi ose Biologji)
- 2-Kursin 3 mujor pranë Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar ,sipas programit të miratuar nga KMR, ku trajnimi do të përfshijë kursin e plotë të radiometrisë dhe dozimetrisë.
- 3- Eksperiencë pune prej 7 vitesh në këtë fushë(mbrojtje nga rrezatimet)

Elementë të vecantë

-Procedura duhet të jetë në përputhje me ligjin mbi dypunësimin apo konfliktin e interesit, duke theksuar se ekspertët që janë të angazhuar në institucione shtetërore nuk mund të hapin institute paralele për të njëjtin aktivitet.

-Nuk mund të gëzojnë titullin institute të njohur nga KMR, por thjesht persona fizikë të cilët do të gëzojnë titullin ekspert.

-Ekspertët, të cilët do të aplikojnë për t'u njohur nga KMR të jenë të regjistruar në institucionet përkatëse sic janë, QKL ose QKR.

-Personat që gëzojnë titullin ekspert nuk mund të ushtrojnë këtë veprimtari për sa kohë janë anëtarë të KMR për shkak të konfliktit të interesit.

-IFBZ të mbulojë me ekspertizë burimet e kategorisë 1 dhe 2, si dhe qendrat që kanë në përdorim burime të hapura. KMR mund të autorizojë një nga ekspertët për raste të vecanta kur është e nevojshme

-IFBZ të paraqesë në KMR një listë cmimesh në lidhje me ekspertizat.

Në rast të ankesave, aplikuesi i drejtohet Kryetarit të KMR-së me një letër ankesë me sqarimet përkatëse. Nqs dhe në këtë rast i refuzohet e drejta, personi mund ti drejtohet gjykatës.

SEKRETARI

Rustem PACI

KRYETARI

Ilir BEQAJ

VËRTETIM

Vërtetojmë se Z./Znj.....
ka dorëzuar në IFBZ dosjen për aplikim për

.....
Me nr rendordatë.....

Numri i faqeve në total

Personi përgjegjës për pranimin e dokumentacionit në IFBZ	Personi juridik ose fizik që dorëzoi dokumentat
Emër _____ Mbiemër _____	Emër _____ Mbiemër _____ Nr karte identiteti _____
Firmë	Firmë

Ky vërtetim nuk e përjashton ekspertin nga asnjë lloj detyrimi tjetër ligjor